



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**



**QENDRA E BOTIMEVE
PËR DIASPORËN**

Nr. 66/ Prot, datë 18.04.2024

Nr. 7/ Prot, datë 18.04.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

DHE

QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

**ME QËLLIM PROMOVIMIN DHE RUAJTJEN E TRASHËGIMISË
KULTURORE DHE GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË**

PREAMBUL

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën (në vijim referuar si Palët) në vlerësim të qëllimeve të përbashkëta për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe, identitetit kulturor kombëtar dhe promovimin e pjesëtarëve të diasporës,

Agjencia Kombëtare e Diasporës, është person juridik publik me seli në Tiranë, institucion në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme e cila është krijuar dhe funksionon bazuar në Vendimin Nr.120 datë 6.03.2024 e Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”

Misioni i saj është të kontribuojë, të nxisë e të promovojë rritjen e vlerave dhe të traditave më të mira kombëtare dhe këtë e realizon përmes ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare.

Qendra e Botimeve për Diasporën është person juridik publik me seli në Tiranë, institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në Republikën e Shqipërisë e cila është krijuar dhe funksionon bazuar në Vendimin Nr. 469 Datë 26.7.2018 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” i ndryshuar me Vendimin Nr.75 datë 14.02.2024 të Këshillit të Ministrave.

Misioni i saj është mbështetja e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë përmes botimit, sigurimit të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese.

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës;

Me dëshirën për të nxitur brezat e rinj në angazhimin me projekte të veçanta të programeve edukative dhe kulturore që promovojnë traditat, historinë dhe kulturën shqiptare;

Duke konsideruar vizitat e rregullta dhe periodike në vendlindje si një nga mënyrat e njohjes së vendit të origjinës dhe si mekanizëm për të mbajtur gjallë interesin e brezit të ri të shqiptarëve në diasporë;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj Marrëveshje për të përmbushur angazhimet në kuadër të politikës shtetërore për diasporën shqiptare;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Marrëveshje.

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e përvojës dhe realizimin e projekteve për mbështetjen, promovimin dhe përhapjen e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Neni 2

Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Hartimin dhe zbatimin e projekteve, aktiviteteve, konferencave, seminareve të përbashkëta për ruajtjen, promovimin e gjuhës shqipe, letërsisë dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- b. Zbatimin e programeve të përbashkëta me qëllim realizimin e shkëmbimeve kulturore, nëpërmjet vizitave të rregullta dhe periodike në vendlindje si një nga mënyrat e njohjes së vendit të origjinës dhe si mekanizëm për të mbajtur gjallë interesin e brezit të ri të shqiptarëve në diasporë;
- c. Hartimin e nismave dhe projekteve të tjera që i shërbejnë interesit të diasporës.

Neni 3

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët do të marrin masat e duhura për të siguruar bashkëpunimin dhe ndërlidhjen efektive ndërmjet tyre.
2. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të diasporës dhe Drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën do të konsultohen rregullisht me njëri-tjetrin, për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

Neni 4

Marrëveshje shtesë

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën mund të aplikojnë për lidhjen Aneks Marrëveshje të veçanta shtesë, bazuar në vullnetin dhe nevojat për bashkëpunim të ndërsjellë të palëve.

Neni 5

Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion nuk do t'i komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje.
3. Palët duhet të respektojnë dispozitat e Ligjit Nr.35, datë 31/3/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse.
4. Pala nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe / ose Donatorin përkatës.
5. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshje.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organeve kompetente gjyqësore.

Neni 7

Kohëzgjatja dhe ndryshimi

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ai mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Agjencisë Kombëtare për Diasporën dhe dy kopje pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën.
2. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.
3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të bëhet me shkrim nga njëra palë dhe do të hyjë në fuqi pas pranimi të saj me shkrim nga pala tjetër.
4. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim 6 (gjashtë) muaj përpara palës tjetër.
5. Kjo Marrëveshje lidhet me afat të pacaktuar.

Nënshkruar në Tiranë, më _____.2024.

**AGJENCIA KOMBËTARE
E DIASPORËS**

**DREJTOR EKZEKUTIV
NË MUNGESË DHE ME POROSI**

MIRELA PHANASI



QENDRA BOTIMEVE PËR DIASPORËN

**DREJTOR
MIMOZA HYSA**

**NË MUNGESË DHE ME POROSI
FABJOLA CAUSHAJ**

